

## Kombetarja/ De Biazi ben gati formacionin me nje sulmues

nga AlbaniaSoccer  
E enjte, 10 Tetor 2013 14:26

---



Shqiperia pergatitet per te luajtur ndeshjen e rradhes me Zvicren. Xhani De Biazi ka disa dite qe po teston formacionin por duket se vetem te enjten eshte bindur per menyren se si duhet te luajne kuqezinjte perballe helveteve. Tekniku Italian ka menduar nje skuader me shume lojtare ne mesfushe dhe nje sulmues te vetem. Kete strategji De Biazi e ka menduar per ti bere balle lojtareve cilesore qe Zvicra ke ne perberje. Ne mbrojtje pritet te luajne Lila, Mavraj, Cana dhe Agolli. Ne mesfushe do te luajne Roshi, Bulku, Basha, Rama dhe Kace I avancuar pas Salihit qe pritet te luaj ne sulm. Deri te merkuren De Biazi po mendonte te hidhte ne fushe edhe Bekim Balen perkrah Salihit por ka ndryshuar mendje.

Formacioni mundshem 4-4-1-1

Berisha

Lila Mavaraj Cana Agolli

Rama Bulku Basha Rama

Kace

Salih